
Miratohet
Kryetari i Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet
Minister i Shendetesise
Petrit VASILI

Sekretari
Rustem PACI

PROCEDURAT E VLERESIMIT TE APLIKIMIT PER
LICENCE TE VEPRIMTARIVE ME BURIME TE
RREZATIMIT JONIZUES
INSPEKTIMI, PROTOKOLLI I INSPEKTIMIT
MODEL I PERGATITJES SE RAPORTIT TE INSPEKTIMIT
FORMAT SHPJEGUES NE LIDHJE ME PLOTESIMIN E
APLIKIMIT PËR LICENSE
FORMATI I DOREZIMIT TE APLIKIMIT
MODEL I VLERESIMIT TE APLIKIMIT PER LICENSE

PROCEDURAT E VLERESIMIT TE APLIKIMIT PER LIGENCE TE VEPRIMTARIVE ME BURIME TE RREZATIMIT JONIZUES

Aplikimi per license behet per te gjitha veprimtarite qe i parashikon ligji “Per mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese ” Nr. 8025 date 9/11/1995 i ndryshuar. Aplikimi per license behet prane ZMR tek personi i ngarkuar per kete qellim.(jo ne menyre elektronike ose me poste).Personi pergjegjes pret perdoruesit nga te cilet njoftohet nepermjet plotesimit te formatit per njoftim. Pasi ben vleresimin e menjehershem njofton perdoruesin ne lidhje me procedurat e metejshme. Personi pergjegjes i ZMR i ve ne dispozicion aplikimin dhe formatin sqarues per plotesim te metejshem.(bashkengjitur ketij materiali) . Pas plotesimit, aplikimi dorezohet ne ZMR duke shenuar daten e dorezimit, nr e fleteve, sipas formatit te percaktuar (Bashkengjitur ketij materiali) nga nje person i autorizuar i subjektit,,i cili mbahet ne dy kopje,nje kopje i jepet perdoruesit si vertetim i dorezimit te dokumentacionit.Personi pergjegjes i ZMR-se ben nje vleresim te pergjithshem te aplikimit duke pare plotesimin e te gjitha rubrikave dhe pas plotesimit te dosjes ajo siglohet ne faqen e pare nga ai dhe i dergohet kryetarit per procedure te metejshme jo me vone se 24 ore nga momenti i dorezimit. Nqs per arsye te ndryshme personi pergjegjes nuk gjendet ne ZMR, paraprakisht kjo detyre i ngarkohet ne menyre te perkoheshme nje prej inspektoreve te ZMR me miratim te kryetarit. Kryetari ben shperndarjen per vleresimin e metejshem nepermjet shenimeve perkatese.Per plotesimin e raportit vleresues mund te kerkohen dokumente shtese kur eshte e nevojshme ose behet verifikimi ne vend nepermjet nje inspektimi ne ambientet ku do te kryhet veprimtaria . Ky vleresim bazohet ne aktivitetin e burimit dhe praktiken duke marre ne konsiderate riskun qe vjen nga kjo veprimtari.

Raporti vleresues duhet te jete i plote dhe duhet te perfshije te gjitha elementet sipas Modelit per Vleresim(bashkengjitur ketij materiali) dhe te siguroje qe e gjitha veprimtaria eshte ne peputhje me rregulloret e miratuara dhe te gjitha elementet e aplikimit per ligure jane plotesuar .Ky raport vleresues per burimet e kategorise 1 dhe 2 pergatitet brenda 4 javesh nga momenti i marrjes se detyres, per burimet kategorise 3,4,5 dhe gjeneratoret me rreze x brenda 2 javesh.Raporti mban ne fund firmen e inspektorit dhe daten e dorezimit tek Kryetari i ZMR.

Ky raport i paraqitet Komisionit te Mbrojtjes nga Rrezatimet per dhenien e vendimit perfundimtar ne lidhje me praktiken. Mbas miratimit nga KMR firmoset dosja perfundimtare nga Kryetari i ZMR.

E gjitha veprimtaria e mesiperme ne ZMR duhet te jete pjese e punes ne grup, si element shume i rendesishem ne realizimin me sukses te detyrave.

Inspektimi

Protokolli i inspektimit

Qellimi i inspektimit eshte te vleresohet perputhja me kerkesat regullatore ne vazhdimesi, per tu siguruar qe praktikat jane duke u zbatuar ne menyre te sigurte dhe burimet jane te siguruar, si nga pikepamja fizike dhe e mbrojtjes prej tyre.

Cdo vit ZMR pregatit planin vjetor te inspektimeve mbi bazen e riskut .i cili miratohet ne KMR. ISHP mbeshtet me logjistike realizimin e planit te inspektimeve.

Inspektimet zakonisht jane te njoftuara por ne raste te vecanta kur ka indikacione per shkelje te veprimtarise se sigurte ato behen pa njoftuar ne kohe te pershtatshme. Inspektimi kryhet te pakten nga dy persona, me shenimin perkates te Kryetarit te ZMR per daten dhe objektivin e inspektimit. Inspektori duhet qe perpara inspektimit te informohet nepermjet dokumenteve per te gjithë veprimtarine e subjektit si dhe duke marre ne konsiderate raportet paraprake. Procesi i inspektimit te marre ne konsiderate listat e kontrollit gjate inspektimit. Inspektori pregatit leter njoftuese me firmen e tij dhe Kryetarit per subjektin i cili do te inspektohet. Ne raste te vecanta njoftohet me tel dhe bie dakort per daten e inspektimit duke i dhene po ate dite dhe letren shoqeruese per inspektim. Para inspektimit laboranti verifikon pajisjet dhe daten e kalibrimit te tyre kur ka nevojë per matje dhe i ve ne dispozicion inspektorit pajisjet dhe shoqeron kur eshte e nevojshme. Gjithmone inspektori duhet te jete i pajisur me dozimetren e tij personal. Ne rastet kur nevojitet makine duhet ti behet nje kerkese me shkrim administrates per kete ceshtje te pakten dy jave para.(ketu nuk perfshihen rastet e emergjences)

Inspektimi ne terren.

Gjate inspektimit ne terren inspektoret prezantohen tek perfaqesuesi i subjektit duke treguar karten e inspektorit. Ato bejne nje prezantim te shkurter ne lidhje me objektivin e inspektimit. Inspektori shoqerohet nga personi pergjegjes per mbrojtjen nga rrezatimet ose nje nga stafi i subjektit. Bazuar ne objektivin e inspektimit, inspektoret mund te kontrollojne te gjithë veprimtarine qe lidhet me sigurimin dhe sigurine e burimeve te rrezatimit jonizues si inventaret, mbetjet, te bejne matje, kontrollojne punen e stafit, shenjat e rrezikut radioaktiv, rrjedhje te rrezatimit veshjet me plumb,modifikimet e mundshme etj. Inspektori gjithashtu kontrollon regjistrat dhe dozen ne ambjente te ndryshme si dhe dozen per publikun, personelin dhe pacientin ne rastet e egzaminimeve mjeksore. Per inspektimet e panjoftuara, inspektoret verejne drejtperdrejt praktiken per te cilen kane dyshime. Inspektoret kontrollojne gjithashtu dhe trajnimin, shkallen e pergjegjesive te stafit duke perfshire dhe procedurat e brendshme. Inspektoret kontrollojne ne detaje zbatimin e programit te mbrojtjes nga rrezatimet, gjithashtu konfirmojne vlefshmerine e licences ne perputhje me aktivitetin. Inspektoret kane te drejte te nderpresin veprimtarine ne rast risku per personelin, publikun ose pacientin. Me mbajtjen e shenimeve perkatese inspektori ne dalje paraqet shkurt elementet e inspektimit dhe gjendjen per ato elemente qe kane prioritet. Brenda dy javesh nga data e inspektimit inspektori ploteson raportin e inspektimit sipas modelit te miratuar dhe e paraqet ate te Kryetari i ZMR me firmen e tij (Modeli i Raportit eshte i miratuar nga KMR Nr 5027/3 date 2 Dhjetor 2010)Inspektori paraqet ne raport dhe shkeljet te konstatuara gjate inspektimit duke percaktuar afate kohore per korigjimin e tyre ne perputhje me legjislacionin..

Pasi raporti miratohet dhe siglohet nga Kryetari, nje kopje e raportit bashke me shkresen shoqeruese i dergohet subjektit. Inspektori ndjek me tej plotesimin e detyrimeve nga subjekti dhe ve ne dijeni kryetarin e ZMR.

Me dergimin e raportit tek subjekti procedura e inspektimit quhet e mbyllur. Raporti pergatitet ne tre kopje nga te cilat nje kopje e raportit mbahet ne arkiven e ZMR nje kopje e mban vete inspektori. Raporti dokumentohet nga inspektori dhe ne version elektronik.

Per vendosjen e sanksioneve gjate inspektimit inspektori duhet te shfrytetoje te gjitha materialet e miratuara nga KMR ne lidhje me Proces verbalin, Vendimin, shkallen e penalizimit etj. Rendesia e vecante duhet ti kushtohet justifikimit ligjor te sanksioneve dhe dhe plotesimit te dokumentacionit ne kete drejtim.

Format shpjegues ne lidhje me plotesimin e aplikimit për licensë
Gjeneratorë me rreze X

Aplikimi duhet të plotësohet në të gjitha pikat dhe mund të shtohen flete në format A4 me shjegime shtese duke ju referuar kërkesave perkatese ne aplikim.

Pika 1 e aplikimit – Të plotësohet me të gjitha të dhënat që kërkohen
Të bashkëngjitet kopja e regjistrimit të QKR, si dhe ekstrakti historik me të dhënat të qarta për subjektin dhe veprimtarinë në momentin e aplikimit .

Pika 2 – Planimetria të paraqitet në një format të qartë dhe të specifikuar në mënyrë të dukshme me të gjithë elementet. Të paraqitet një dokument i cili jep destinacionin e ambienteve ku do ushtrohet veprimtaria. (Të merret në konsideratë në aplikim Urdhëri nr. 547, dt 14.10.2008 i Ministrisë të Shëndetësisë për ndertimin e kabinetëve të radiologjisë dhe ato me burime të hapura dhe të mbyllura radioaktive).

Paraqisni një dokument në lidhje me mënyrën se si e keni përfituar pajisjen (Dokumentin e blerjes, një kopje të certifikatës së cilësisë brenda dy viteve të fundit ose aktin e garancisë)

Pika 3 – Të plotësohet me të gjitha të dhënat siç kërkohen.

Për më shumë se një pajisje të dhënat të jepen në një fletë shtesë me të njëjten strukturë dhe t'i bashkëngjitet aplikimit.

Pika 4 – Të paraqitet një material i shkurtër me shkrim mbi qëllimin e përdorimit të pajisjes

Pika 5 – Të paraqitet një kopje e kontratës së mirëmbajtjes ose të sqarohet me shkrim se si do të realizohet mirëmbajtja.

Pika 6- Të paraqitet një raport i shkruar nga një ekspert i kualifikuar i njohur nga KMR. Në raport të jepet :

- niveli i dozës efektive vjetore për ambientet publike, në zonat e kontrolluara dhe të survejuara,

- përlllogaritja e trashësisë në lidhje me materialin për çdo faqe të kabinetit, duke dhënë një informacion të plotë për justifikimin dhe optimizimin e praktikës.

Pika 7 – Të paraqitet lista emerore e punonjësve të kabinetit radiologjik, dhe të bashkëngjiten kualifikime të rinovuara në pesë vitet e fundit. Në listë të përcaktohen personat të cilët kanë akses në zonat e kontrolluara. Të paraqitet dhe një dokument mbi programin e mbrojtjes nga rrezatimet.

Pika 8 – Të paraqitet një kopje e kontratës për dozimetrimin personal, e cila të jetë e përshtatshme për llojin dhe energjitë e rrezatimit që keni në përdorim. Kontrata të paraqesë qartë detyrimet e secilës pale

Të kontaktohet me Z. Niko Civici, Përgjegjës i QFBZ

Nr tel 2362596,0692624144

Email: nikocivici@yahoo.com

Pika 9 – Të plotësohet sipas kërkesës.

Pika 10- Të paraqitet një dokument i vecante ne lidhje me procedurat per trajtimin e aksidenteve.

Pika 11 – Të paraqitet një regullore e brendeshme e qendres suaj

Pika 12 – Të paraqitet në një dokument per menyren e ruajtjes së të dhënave sic kerkon aplikimi.

Pika 13 – Të paraqitet vlerësimi për sigurinë, sigurimin dhe mbrojtjen nga rrezatimi ne vazhdim te dokumentit te pikes 6 si dhe te meren ne konsiderate :

Ngarkesa vjetore maksimale

Faktori i zenies

Faktori i perdorimit

Materialet e ndertimit densiteti dhe trashesia

Klasifikimi i zonave

Pajisjet personale mbrojtese

Monitorimi i vendeve te punes

Rrethanat e posacme

Vendosja e shenjave te rezikut te rrezatimit jonizues

Instrumentet dhe kalibrimi ityre

Teste per rrjedhje

Pika 14 – Të paraqitet një dokumenti i plotesuar sipas formatit te survejances mjekesore.

Aplikimi duhet të plotësohet duke përcaktuar për cfarë kërkohet licensa (përdorim, import/eksport, transport të gjeneratorëve me rreze X etj) dhe të vendoset data kur dorëzohet në ZMR, të nënshkruhet nga përfaqësuesi ligjor i subjektit dhe vulozet. Vula e subjektit duhet të vendoset në cdo faqe të dokumentacionit. Ne rast te mungeses se vules te noterizohet dokumentacioni i pergatitur nga subjekti.

Pas plotësimit me kujdes të rubrikave të këtij formulari te dorezohet tek personi pergjegjes ne ZMR

Format shpjegues ne lidhje me plotesimin e aplikimit për licensë
Burime radioaktive të hapura dhe të mbyllura

Aplikimi duhet të plotësohet në të gjitha pikat dhe mund të shtohen flete në format A4 me shjegime shtese duke ju referuar kërkesave perkatese ne aplikim.

Pika 1 e aplikimit – Të plotësohet me të gjitha të dhënat që kërkohen.

Të bashkëngjitet kopja e regjistrimit në QKR, si dhe ekstrakti tregtar me të dhënat të qarta për subjektin dhe veprimtarinë në momentin e aplikimit.

Pika 2 – Planimetria të paraqitet në një format të qartë dhe të specifikuar në mënyrë të dukshme me të gjithë elementet. Të paraqitet një dokument, i cili jep destinacionin e ambienteve ku do ushtrohet veprimtaria. (Të merret në konsideratë në aplikim Urdhëri nr. 547, dt 14.10.2008 i Ministrisë të Shëndetësisë për ndertimin e kabineteve të radiologjisë dhe ato me burime të hapura dhe të mbyllura radioaktive). Të paraqitet plani i sigurisë fizike.

Paraqisni një dokument në lidhje me mënyrën se si e keni përfituar burimin (Dokumenti i blerjes si dhe një kopje të certifikatës së cilësisë së burimit).

Pika 3 – Të plotësohet me të gjitha të dhënat siç kërkohen.

Për më shumë se një burim të dhënat të jepen në një fletë shtesë me të njëjten strukturë dhe t'i bashkëngjitet aplikimit.

Pika 4 – Të paraqitet një material i shkurtër me shkrim mbi qëllimin e përdorimit të burimit.

Pika 5 – Të paraqitet një kopje e kontratës së mirëmbajtjes së pajisjes që përdor burimin ose të sqarohet me shkrim se si do të realizohet mirëmbajtja.

Pika 6- Të paraqitet një raport i shkruar nga një ekspert i kualifikuar i njohur nga KMR. Në raport të jepet:

- niveli i dozës efektive vjetore për ambientet publike, në zonat e kontrolluara dhe të survejuara,
- rregullat e sigurisë teknike dhe të manipulimit të pajisjes që ka burimin, siguria fizike duke dhënë një informacion të plotë për justifikimin dhe optimizimin e praktikës.

Pika 7 – Të paraqitet lista emerore e punonjësve që do të manipulojnë me burimin ose pajisjen që ka burimin dhe të bashkëngjiten kualifikime të rinovuara në pesë vitet e fundit. Në listë të përcaktohen personat të cilët kanë akses në zonat e kontrolluara. Të paraqitet dhe një dokument mbi programin e mbrojtjes nga rrezatimet.

Pika 8 – Të paraqitet një kopje e kontratës për dozimetrimin personal, e cila të jetë e përshtatshme për llojin dhe energjitë e rrezatimit që keni në përdorim. Kontrata të paraqesë qartë detyrimet e sejciles pale.

Të kontaktohet me Z. Niko Civici, Përgjegjës i QFBZ

Nr tel 2362596, 0692624144

Email: nikocivici@yahoo.com

Pika 9 – Të plotësohet sipas kërkesës.

Pika 10- Të paraqitet një dokument i vecante ne lidhje me procedurat per trajtimin e aksidenteve.

Pika 11 – Të paraqitet kontrata per kthimin e burimit në vendin e origjinës ose kontrata për trajtimin e saj në fund të përdorimit në qendrën përkatëse (QFBZ).

Pika 12 – Të paraqitet një dokument per menyren e ruajtjes së të dhënave sipas kërkesës.

Pika 13 – Të paraqitet vlerësimi për sigurinë, sigurimin dhe mbrojtjen nga rrezatimi ne vazhdim te dokumentit te pikes 6 si dhe te merren ne koniderate :

Ngarkesa vjetore maksimale

Faktori i zenies

Fak i perdorimit

Materialet e ndertimit, densiteti dhe trashesia

Klasifikimi i zonave

Pajisjet personale mbrojtese

Monitorimi i vendeve te punes

Rrethanat e posacme

Vendosja e shenjave te rrezikut te rrezatimit jonizues

Instrumentet dhe kalibrimi ityre

Teste per rrjedhje

Siguria fizike dhe mbrojtja ne thellësi

Trajtimi ne fund të përdorimit

Pika 14 – Të paraqitet një dokument i plotësuar sipas formatit te survejances mjekesore.

Aplikimi duhet të plotësohet duke përcaktuar për cfarë kërkohet licensa (përdorim, import/eksport, transport të burimeve radioaktive, etj) dhe të vendoset data kur dorëzohet në ZMR, të nënshkruhet nga përfaqësuesi ligjor i subjektit dhe vuloset. Vula e subjektit duhet të vendoset në cdo faqe të dokumentacionit. Në rast të mungesës së vulës të noterizohet dokumentacioni i përgatitur nga subjekti.

Pas plotësimit me kujdes të rubrikave të këtij formulari te dorezohet tek personi pergjegjes ne ZMR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet
Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet

A Moisiu No 80 Tiranë tel / +355 423 70057 fax: + 355 423 70058 : e-mail : rpaci@moh.gov.al

VËRTETIM

Vërtetojmë se Z./Znj.....
ka dorëzuar në ZMR dosjen për aplikim për

.....
Ne nr rendordate.....
Numri i faqeve ne total

Personi pergjegjes per pranimin e dokumentacionit ne ZMR	Personi juridik ose fizik qe dorezoi dokumentat
Emer _____ Mbiemer _____ Firme	Emer _____ Mbiemer _____ Nr karte identiteti _____ Firme

Ky vertetim nuk nekupton faktin qe perdoruesi do te licencohet dhe nuk e perjashton nga asnje lloj detyrimi tjeter ligjor

MODEL I VLERESIMIT TE APLIKIMIT PER LICENSE

Subjekti

Subjekti (emri), me perfaqesues Z. ka aplikuar prane ZMR me **date** per e licenses së këtij subjekti. Subjekti ndodhet ne Rrugën Nr.,.....QytetiTel fax email .

Pajisjet

Disponon aparaturën ose burimin me te dhenat e meposhtme:

Subjekti ne aplikimin e tij ka plotesuar rubrikat e aplikimit te licenses, ne perputhje me rregulloren mbi “Licensimin dhe inspektimin e veprimtarive me burime te rrezatimit jonizues” te miratuar me VKM nr.10 date 07.01.2010 dhe rregulloreve te tjera perkatese

Aplikimi

Subjekti ka plotesuar:

1- Aplikimin e licensës.

Ka paraqitur

2- Ka paraqitur planimetrine per ambjentin sipas kerkesave ne aplikim.
Vertetimin hipotekor mbi destinacionin e ambjenteve te godinës,

3- Ka plotësuar rubriken me të dhënat për pajisjen.

4- Ka plotesuar rubrikën duke shpjeguar qëllimin e përdorimit të pajisjes

5- Ka plotësuar rubrikën duke shpjeguar mënyrën e mirëmbajtjes së pajisjes

6-Eshte kryer ekspertiza nga, ekspert i kualifikuar i njohur nga KMR sipas nenit 3 te rregullores per licencim dhe inspektim . Në raport paraqitet

Doza efektive vjetore per publikun e perllogaritur mSv

Doza efektive vjetore e personelit mSv

Përllogaritja e trashesise dhe materialit per cdo faqe

Ekspertiza konkludon që subjekti kryen veprimtari te sigurte per publikun dhe personelin duke mare ne konsiderate optimizimin e dozave.

7 – Ka paraqitur strukturën organizative, kualifikimet e stafit të rinovuara në 5 vjetët e fundit. Ka paraqitur programin per mbrojtjen nga rrezatimet.

8 - Ka paraqitur kontratën per dozimetrine personale,ose transport apo trajtim mbetjesh me QFBZ

9 - Është percaktuar si person pergjegjes per mbrojtjen nga rrezatimi Z., i kualifikuar

10 – Ka paraqitur një plan emergjencash.....

11 – Ka paraqitur rregulloren e brendshme të qendrës/ose kontraten per burimin e konsumuar

12 - Ka sqaruar mënyrën e ruajtjes së dokumentacionit

13 – Ka paraqitur një dokument që subjekti siguron një punë të sigurtë për publikun dhe personelin me optimizim të dozave, duke dhënë vlerësimin për sigurinë, sigurimin dhe mbrojtjen nga rrezatimi jonizues si më poshtë

Ngarkesa vjetore maksimale

Faktori i zënies

Faktori i përdorimit

Materialet e ndërtimit, densiteti dhe trashësia

Klasifikimi i zonave

Pajisjet personale mbrojtëse

Monitorimi i vendeve të punës

Rrethanat e posacme

Vendosja e shenjave të rrezikut të rrezatimit jonizues

Instrumentet dhe kalibrimi i tyre

Teste për rrjedhje

Siguria fizike dhe mbrojtja në thellësi

Trajtimi në fund të përdorimit,
si pjesë e ekspertizës.

14 -Eshtë paraqitur formulari mbi survejancën mjekësore

Konkluzione

Duke u bazuar në dokumentacionin e dërguar pranë ZMR-se dhe në inspektimin e kryer pranë këtij subjekti, mendoj që veprimtaria e këtij kabineti me burime të rrezatimit jonizues është në përputhje me rregulloret në fuqi si dhe rubrikat e aplikimit për license janë plotësuar në mënyrë korrekte.

Inspektor

Tirane,



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E SHENDETESISE
Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet
Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet

Aleksander Moisiu No 80 Tirana Tel : + 355 42 37 00 57 ; + 355 68 20 57 353 Fax + 355 42 37 00 59 rpaci@moh.gov.al

NJOFTIM

PER VEPRIMTARI ME BURIME TE RREZATIMIT JONIZUES

☐ Personit juridik/fizik Emri Mbiemri Adresa _____

_____ Tel. _____ Fax _____ E-mail _____

☐ Emri dhe adresa e Institucionit _____

☐ Identifikimi i burimit te rrezatimit jonizues

LENDA RADIOAKTIVE:

Aktiviteti (Bq):

Forma kimike:

Burime ne trajte te mbyllur:

☐ Po

☐ Jo

Modeli i burimit:

Prodhuesi:

Kodi :

GJENERATOR RREZATUES:

Tensioni i larte:

Modeli:

Prodhuesi:

☐ Godina ne te cilen vendoset burimi i rrezatimit jonizues

☐ Lloji i punes qe kryhet me burimin e rrezatimit jonizues.

☐ Pika doganore e hyrjes ne territorin e Shqiperise te burimit te rrezatimit _____

☐ Data e importimit dhe kompania importuese _____

Data _____

Subjekti

RELACION

Ne kuadrin e nje menaxhimi cilesor te punes ne zyren e Mbrojtjes nga rrezatimet me qellim lehtesimin dhe standartizimin ne pergatitjen e dokumentacionit prane kesaj zyre ne perputhje dhe me dokumentet e ANEA's jane pergatitru dorkumentat e meposhtem :

PROCEDURAT E VLERESIMIT TE APLIKIMIT PER LICENCE TE VEPRIMTARIVE ME BURIME TE RREZATIMIT JONIZUES

Keto procedura marin ne konsiderate te gjithë hapat e aplikimit deri ne vleresim nga ana e KMR.ZMR percakton nje person pergjegjes per gjithë kete veprimtari. Personi pergjegjes i ZMR i ve ne dispozicion aplikimin dhe formatin sqarues dhe pas plotesimit, aplikimi dorezohet ne ZMR duke shenuar daten e dorezimit, nr e fleteve. Pas vleresimit te pergjithshem dosja siglohet dhe i dergohet kryetarit per procedure. Kryetari ben shperndarjen per vleresimin e metejshe. Per plotesimin e raportit vleresues mund te kerkohen dokumente ose behet verifikimi ne vend nepermjet nje inspektimi.Raporti vleresues duhet te jete i plote sipas Modelit per Vleresim.Kjo percakton dhe kohen e pergatitjes se raportit.Ky raport i paraqitet Komisionit te Mbrojtjes nga Rrezatimet per dhenien e vendimit.

Inspektimi

Protokolli i inspektimit

Qellimi i inpektimit eshte te vleresohet perputhja me kerkesat regullatore ne vazhdimesi.Inspektimet zakonisht jane te njoftuara,por dhe pa njoftuar dhe kryhet te pakten nga dy persona. Inspektori duhet te informohet nepermjet dokumenteve per te gjithë veprimtarine e subjektit si dhe duke marre ne konsiderate raportet paraprake. Procesi i inspektimit te marre ne konsiderate listat e kontrollit si dhe proceduren e plote per inspektim. Laboranti verifikon pajisjet dhe daten e kalibrimit te tyre kur ka nevoje per matje dhe i ve ne dispozicion inspektorit, ai duhet te jete i pajisur me dozimetrit e tij personal.

Inspektimi ne terren.

Ky paragraf paraqet menyren e inspektimit me detajet e saj. Inspektoret mund te kontrollojne te gjithë veprimtarine qe lidhet me sigurimin dhe sigurine e burimeve te rrezatimit jonizues si inventaret, mbetjet, te bejne matje, kontrollojne punen e stafit, shenjat e rrezikut radioaktiv, rrjedhje te rrezatimit veshjet me plumb,modifikimet e mundshme etj. Inspektori gjithashtu kontrollon regjistrat dhe dozen ne ambiente te ndryshme si dhe dozen per publikun, personelin dhe pacientin ne rastet e egzaminimeve mjeksore. Per inspektimet e panjoftuara, inspektoret verejne drejtperdrejt praktiken per te cilen kane dyshime. Inspektoret kontrollojne gjithashtu dhe trajnimin, shkallen e pergjegjesive te stafit duke perfshire dhe procedurat e brendshme. Inspektoret kontrollojne ne detaje zbatimin e programit te mbrojtjes nga rrezatimet, gjithashtu konfirmojne vlefshmerine e licences ne perputhje me akltivitetin. Inspektoret kane te drejte te nderpresin veprimtarine ne rast risku per personelin, publikun ose pacientin. Brenda dy javesh nga data e inspektimit inspektori ploteson raportin e inspektimit sipas modelit te miratuar dhe e paraqet ate te Kryetari i ZMR me firmen e tij. (Modeli i Raportit eshte i miratuar nga KMR Nr 5027/3 date 2 Dhjetor 2010)Inspektori paraqet shkeljet te konstatuara duke percaktuar afate kohore per korigjimin.Pasi raporti miratohet dhe siglohet nga Kryetari, nje kopje e raportit

bashke me shkresen shoqeruese i dergohet subjektit. Inspektori ndjek me tej plotesimin e detyrimeve nga subjekti dhe ve ne dijeni kryetarin e ZMR.

Me dergimin e raportit tek subjekti procedura e inspektimit quhet e mbyllur. Raporti pergatitet ne tre kopje nga te cilat nje kopje e raportit mbahet ne arkiven e ZMR nje kopje e mban vete inspektori. Raporti dokumentohet nga inspektori dhe ne version elektronik.

Per vendosjen e sanskioneve gjate inspektimit inspektori duhet te shfrytetoje te gjitha materialet e miratuara nga KMR

Format shpjegues ne lidhje me plotesimin e aplikimit per licensë
Gjeneratorë me rreze X, burime radioaktive .

Ky format shpjegues eshte ne peputhje me aplikimin per licence dhe eshte dokument shtese ne lidhje me sqarimet e mundshme per aplikimin dhe permban te gjitha elementet sqarues ne lidhje me aplikimin. keto elemente japin ne myre te qarte se cfare duhet te plotesohet nga ana e perdoruesit per nje pune te sigurte me burime te rrezatimeit jonizues. Elemente te cileve duhet tu kushtohet nje rendesi e vecante jane.

Ngarkesa vjetore maksimale

Faktori i zenies

Faktori i perdorimit

Materialet e ndertimit densiteti dhe trashesia

Klasifikimi i zonave

Pajisjet personale mbrojtese

Monitorimi i vendeve te punes

Rrethanat e posacme

Vendosja e shenjave te rezikut te rrezatimit jonizues

Instrumentet dhe kalibrimi ityre

Teste per rrjedhje

Aplikimi duhet të plotësohet duke përcaktuar për çfarë kërkohet licensa të nënshkruhet nga përfaqësuesi ligjor i subjektit dhe vuloset.

Ne te njejtin format jepet dhe shpjegimi ne lidhje aplikimet per burimet radiaktive te hapura dhe mbyllura duke mare ne konsiderate specifikat perkatese.

Vertetimi eshte nje dokument nepermjet te cilit vertetohet dorezimi i dokumentacionit se bashku me numrin e faqeve te dorezuara per vleresim te metejshem. Kjo regullon mardheniet e ZMR me perdoruesin.

Vleresimi i aplikimit per licence eshte nje dokument qe standartizon raportin perfundimtar te inspsektorit ne lidhje me aplikimin dhe ne cdo rubrike jepen ne menyre te qarte se cilat jane detyrimet e plotesuara. Nepermjet vleresimit inspektori ben vleresimin perfundimtar dhe ja paraqet KMR per te mare vendim.